



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA SARANDË**

Sarandë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

## **FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)**

[Data: 27.05.2024]

Drejtuar: [“ILIRIA/D ” SHPK , me NUIS: J66702510D, me adresë: Vlore, Sarande, Lagjja nr.1, rruga Telat Noga, pallati nr.2, ap.nr.4, Sarande. ]

Procedura e prokurimit/lotit: “ **Procedurë e Hapur, Punë**”

**“Rikualifikim i rrugeve te brendeshme ne Ksamil”**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF - 98732-03-19-2024**

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** [Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Rikualifikim i rrugeve te brendeshme ne Ksamil”,Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45233140-2 Punime rrugore , Fondi limit: 25 000 000 (Njezete e pese milion leke ) pa TVSH, Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 30 dite ]

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. “ILIRIA/D ” SHPK**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**J66702510D**

*Numri i NIPT-it*

Vlera: **22 198 300** (njëzet e dy milion e një qind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tre qind) lekë pa TVSH.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

**2. “SARK ” SHPK**

**K52531415H**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Vlera: **21 633 700** (njëzet e një milion e gjashtë qind e tridhjetë e tre mijë e shtatë qind ) lekë pa TVSH.

**3. “JODY- KOMPANY ” SHPK**

**J94824803M**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Vlera: : **24 514 900** (njëzet e katër milion e pesë qind e katërbëdhjetë mijë e nëntë qind ) lekë pa TVSH.

**4. “LIS KONSTRUKSION ” SHPK**

**K66613407H**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Vlera: : **20 999 729** (njëzet milion e nëntë qind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatë qind e njëzet e nëntë ) lekë pa TVSH.

**5. “Rruge Sinjalistike Mirembajtje dhe Hidro Company” dshh ( dega e shoqërisë Meme RSM COMPANY) ” SHPK**

**L04803001U**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Vlera: : **18 164 900** (tetëmbëdhjetë milion e një qind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntë qind ) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. . “LIS KONSTRUKSION ” SHPK**

**K66613407H**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Për arsyet e mëposhtme: Oferta e paraqitur nga “LIS KONSTRUKSION ” SHPK me NUIS: K66613407H , me vlerë 20 999 729 (njëzet milion e nëntë qind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatë qind e njëzet e nëntë ) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit, sepse operatori ekonomik “LIS KONSTRUKSION ” SHPK, nuk plotëson kriterin e pikës 8 të seksionit 2.3 Kapaciteti teknik në të cilin parashikohet : “Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme

teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: 5. Fabrike për prodhim Asfaltobetoni jo më larg se 50 km nga objekti.”. Bazuar në dokumentet standarte të tenderit ky kriter (8) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor. Bazuar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik nuk është deklaruar asnjë fabrikë asfalto betoni në pronësi. ose qera ose me kontratë furnizimi.

**2. “Rruge Sinjalistike Mirembajtje dhe Hidro Company” dshh ( dega e shoqërisë Meme RSM COMPANY) ” SHPK** **L04803001U**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Për arsyet e mëposhtme: Nga verifikimi rezulton që oferta ekonomike e operatorit ekonomik “Rruge Sinjalistike Mirembajtje dhe Hidro Company” dshh ( dega e shoqërisë Meme RSM COMPANY) ” SHPK me NUIS: L04803001U, me vlerë **18 164 900 (tetëmbëdhjetë milion e një qind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntë qind )** lekë pa TVSH është ofertë anomalisht e ulët. Referuar ligjit nr.16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, konkretisht neni 27, pika 5 “ Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët” .

**3. “SARK ” SHPK**

**K52531415H**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

Për arsyet e mëposhtme: Oferta e paraqitur nga “SARK” SHPK me NUIS: K52531415H , me vlerë 21 633 700 (njëzet e një milion e gjashtë qind e tridhjetë e tre mijë e shtatë qind ) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit, sepse operatori ekonomik “SARK” SHPK, nuk plotëson kriterin e pikës 1 të seksionit 2.3 Kapaciteti teknik në të cilin parashikohet : “ Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.”. Nga përllogaritjet e realizuara bazuar në punët e kryera rezulton që nuk plotësohet kushti “ sa dyfishi i vlerës limit të kontratës” sepse shumica e punëve të realizuara është nën këtë vlerë.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [“ILIRIA/D ” SHPK , me NUIS: **J66702510D**, me adresë: **Vlore, Sarande, Lagjja nr.1, rruga Telat Noga, pallati nr.2, ap.nr.4**,

**Sarande]**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **22 198 300 (njëzet e dy milion e një qind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tre qind) lekë pa TVSH** , është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Florjan Sali**